Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1065

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga XX duke vendosur sipas ankesës së OE N.N.P. "HYSNIA", kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të "Komuna e Vushtrrisë" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të katërt" me numër të prokurimit VU644-22-8608-5-2-1, me 05/02/2024, mori:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e OE N.N.P. "HYSNIA" me nr. 2023/1065 , e datës 29/12/2023, kurse vendimi i AK "Komuna e Vushtrrisë" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të katërt" me numër të prokurimit VU644-22-8608-5-2-1 mbetet në fuqi, sipas nenit 105.2.16 të LPP, lënda trajtohet si çështje e gjykuar.

2. Konform nenit 31 par 5 te Rregullores se Punës se OSHP-së, konfiskohen mjetet e deponuaranë emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës nga Operatori Ekonomik N.N.P. "Hysnia." - Vushtrri,

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me: 22.08.2022,OE N.N.P. "HYSNIA" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të katërt" me nr. të prokurimit: VU644-22-8608-5-2-1.

Ndërsa me datën 12.12.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE NNP "WENDA"

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë, dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 130 000,00 €.

Me 18.12.2023, OE N.N.P. "HYSNIA" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 19.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 29.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE N.N.P. "HYSNIA" me nr. 1065/23 për lidhur me aktivitetin "Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të katërt" me nr. të prokurimit: VU644-22-8608-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

*Pretendimet e operatorit ekonomik ankues*OE N.N.P. "HYSNIA" - *janë parashtruar si në vijim:*

Pretendimet e OE ankues:"Të pa kënaqur me Vendimin e Autoriteti kontraktues –KOMUNA E VUSHTRRISË dhe në pajtim me nenin 109 të LPP-së parashtrojmë ANKESË kundër;? Vendimin e AK për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim të dt. 19.12.2023;? Njoftimit te Vendimit te AK për rezultatin e tenderit te datës 12.12.2023.

Arsyetimi i AK nuk është përmbajtjesor, nuk ka ofruar kundër argumente lidhur me tri pretendimet tona, dhe provat që i kanë mbështetet këto pretendime, por ne mënyre diskriminuese, tendencioze dhe ne kundërshtim me nenin 108/A par 8, nen par 8.4 refuzon kërkesën pa i shqyrtuar siç duhet provat, pa i administruar ato një nga një dhe pa i arsyetuar ato në përputhje me kriteret e përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT dhe, rrjedhimisht ky vendim është nxjerrë në shkelje të Ligjit, për me tepër është diskriminues ndaj kompanisë tonë dhe favorizues ndaj OE të propozuar për kontratë.. Ne vijim do ti trajtojmë pretendimet tona ne ANKESË duke e kundërshtuar : ? Vendimin e AK për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim të dt. 19.12.2023; Arsyetimi i AK në pretendimet tona, është i pa pranueshëm, sepse pretendimet tona kanë qene që, AK gjatë ri-vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasim të tenderëve të veproj në përputhje me kriteret e përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT, për faktin se, me as një formë AK nuk ka mundur të arsyetoj pretendimet tona sa i përket:

1. (1) grejder rrafshues min. 12 ton,

2. (1) Cilinder vibrues min. (12-16) ton,

3. (1) Bullduzher për rrafshimin e terenit minimum 8 ton,

Kërkesat e lartë cekura kanë qenë kritere të përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT, por që OE NNP "Wenda" Vushtrri, i shpërblyer me kontratë nuk i plotëson minimumin e kërkesave të AK dhe kjo mund të dëshmohet me anë të provave të argumentuara.

E para: Kërkesa në lidhje me grejder rrafshues min. 12 ton, OE NNP "Wenda" Vushtrri, nuk e ka plotësuar kërkesën e përzgjedhjes të NJK dhe DT, për shkak se ka ofruar pajisje grejder rrafshues me 9.7 tonë. Provë1 : Graderi.pdf Me që rast, pajisja e prezantuar si dëshmi me dud doganor ka kapacitet vetëm 9.7 ton, qe nuk përmbushe kërkesën e A.K. qe Grederi te jete min. 12 ton, që nënkupton se pajisja ne fjale për te arritur te kryej funksionin e saj ne aspektin funksional duhet te jeni me peshe MINIMUM 12 ton.

E dyta: Kërkesa në lidhje me Bullduzher për rrafshimin e tereni minimumi 8 ton, OE NNP "Wenda" Vushtrri, nuk e ka plotësuar kërkesën e përzgjedhjes të NJK dhe DT, për shkak se ka ofruar pajisje nen emërtimin Bager (Bullduzher) i përdorur skipper, TM 50. Provë 3 dhe 4: Bollduzheri.pdf , Fillimisht, O.E. ka prezantuar si bollduzher një makineri qe nuk i plotëson aspak kërkesat e kësaj pike si ne aspektin funksional ashtu edhe te realizimit te punëve te asaj natyre duke prezantuar si Bullduzher mjetin, Lopat ngarkues bager Bollduzher qe mund ta vertetoni ne dokumentacionin e prezantuar me dorëzimin e dosjes se tenderit dokumentacioni ("8.2 Eskavator, Greder, Cilinder, bulduzer", konkretishte dokumenti nr. "10. Bulduzeri") (Prova 3) dhe (Foto 3) ku prezantohet fatura e blerjes, dudi doganor dhe fotoja qe tregon qarte se ky mjet nuk është buldozerë dhe ka peshën vetëm 4.2 ton qe nuk i afrohet as për se afërmi

kërkesës se pikës se lartshënuar (1(Një) Bullduzher për rrafshimin e tereni minimu 8 ton) si dhe ne listën e pajisjeve mund ta gjeni (pajisja Nr. 25) dhe pas kësaj pas kërkesës se A.K për plotësimin me dokumentacion shtese, O.E. ka falsifikuar dokumentet ne lidhur me marrëveshjen për Bullduzher duke pretenduar qe ketë marrëveshje e ka bere me 12.09.2023, por qe realisht po te ishte kjo marrëveshje ne atë kohe O.E. do ta fuste ne pjesën e dokumentacionit dhe do i shkruante këto pajisje ne listën e pajisjeve.

Andaj konkludojme se kjo është një manipulim dhe ne kundërshtim me ligjin, po ashtu O.E. është munduar qe falsifikoj edhe emërtimin e markës se Bullduzherit duke e shkruajtur ne marrëveshjen mbi qiranë se është tip:TM 50 CAT Caterpillar D6 R LGP. Duke e ndërruar tërësisht mjetin te cilin e kishte prezantuar fillimisht me dorëzimin e dosjes se tenderit. E qe realisht tipi i tillë nuk ekziston fare ne treg sepse ka bashkuar emrat e 2 pajisjeve për t'u përshtatur me pajisjen qe O.E ne fjale posedon ne listën e pajisjeve. Pra, O.E. është munduar ta manipuloj edhe listën e pajisjeve te veta pasi qe posedon nje Bager Skip – Pinguely TM 50, mjetin te cilin mund ta identifikoni dhe konfirmoni saktësinë e këtij konkludimi duke hapur dokumentin me titull: ("8.1 Pisje me DUD dhe flete pagesa te bankës", konkretisht dokumenti nr. "10 SKIP Pingunin me rrota") (Prova 4) dhe (Foto 4) si dhe ne listën e pajisjeve mund ta gjeni (pajisja Nr. 22) dhe ne arsyetimin e dërguar me 20.06.2023 O.E. është munduar te arsyetohet se ketë makineri e ka shkruajtur shkurtimisht dhe ka gabuar ne vitin e prodhimit, por ne dudin doganor vërehet se ky është Bager (Skip) krejtësisht tjetër dhe jo Bullduzher dhe nuk e përmbushe kapacitetin teknik prej min 8 ton sikurse është saktësuar ne dosjen e tenderit pjesa FTD, neni 9.1&9.2, pika 4, nen pika 2. Dhe marrëveshja e prezantuar si dokumentacion shtese duhet te konsiderohet e pavlefshme për shkak te mospërputhjeve te cekura me larte.

E treta: Kërkesa në lidhje me Cilinder vibrues min. (12-16) ton, OE NNP "Wenda" Vushtrri, nuk e ka plotësuar kërkesën e përzgjedhjes të NJK dhe DT, për shkak se ka ofruar pajisje nen emërtimin Cilinder TB 700, me kapacitet 8.6 ton. Provë 2: Cilindri.pdf , Prandaj, referuar sqarimeve të lartë cekura, është e qartë që OE NNP "Wenda" Vushtrri, nuk i plotëson kriteret e përzgjedhjes të parapa në DT, për tu konsideruar si i kualifikuar, pra është ne kundërshtim me kërkesat e nenit 51, par 1, sepse nuk ka ofruar dëshmi të argumentuara sipas nenit 64, paragrafi (iii), në lidhje me nenin 69, par, 6, nen paragrafin 6.3 të LPP-se, si dhe në shkelje të dispozitave të nenit Neni 40, par 40.1;40.2;40.6 nen par a),b) dhe c) dhe par 40.13, të rregullores 01/2022. Madje AK, i konsideron si devijime të vogla, siç arsyetohet AK në refuzim të kërkesës për rishqyrtim, por në rastin konkret, kemi të bëjmë me ndryshim të kërkesave/kritereve gjatë vlerësimit, për shkak të diferenca të mëdha në kapacitet-ton, gjë që kjo është e ndaluar me LPP, për faktin se ne bazë të atyre kërkesave/kritereve kemi paraqitur Ofertën në dhe të gjithë OE pjesëmarrës ne ketë aktivitet. Vlen të theksohet se, pajisjet e kërkuara nga AK duhet të plotësojnë minimumin e kritereve sipas DT dhe janë ato që e diktojnë edhe ofertën financiare dhe realizimin e punëve në teren, e jo të pranohen pajisje të cilat janë nen minimumin e kërkuar nga AK, gjë që krijon precedent të rrezikshëm për shkak se nuk ka trajtim të barabartë në mes të palëve në ketë aktivitet. Madje, mungesa e theksuar e minimumit të kapaciteteve të pajisjeve të ofruara nga OE NNP "Wenda" Vushtrri, është vërtetuar edhe ne ekspertizën nr.2023/0494 nga eksperti shqyrtues i OSHP-se por edhe nga Paneli Shqyrtues ne vendimin nr. PSH -2023/0494, se nuk i plotëson kërkesat/kriteret e parapara në NJK dhe DT. Për me tepër, edhe ne ankesat e me hershme te të njëjtit aktivitet, por edhe ne ketë ankese, po u referohemi vendimit të OSHP-se, PSH-765/2022, dt.30.03.2023, si rast, në lidhje me kriteret e përzgjedhjes. Në vendimin e OSHP-se PSH-765/2022, e që konsiderohet raste i ngjashëm në lidhje me

kriteret e përzgjedhjes, ku nder të tjera citojmë: [....], kurse DT përbën dokumentin qenësor të aktivitetit të prokurimit dhe për hire të sigurisë juridike, me paragrafin 3 të nenit 7 të LPP-se, çdo AK i ndalohet shprehimisht çdo shmangieje nga termat dhe kriteret e precizuara në DT, sepse sipas paragrafit 1, të nenit 27 kanë karakter material, kurse devijimi eventual atakon parimin e barazisë sikurse sanksionohet me nenin 7 të LPP-së. Dhe rrjedhimisht, AK ju ka shmangur kritereve të precizuara në DT, prandaj kemi trajtim jo të barabartë ne ketë aktivitet, vlen të theksohet, Neni 7, paragrafët 1, 2 dhe 6, nen paragrafi (iv),(v) dhe (vi) i LPP-se, ndër të tjera, garantojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit publik, sepse i tërë qëllimi i normës së mësipërme është sigurimi i barabarësisë në trajtim të operatorëve ekonomik në mënyre barbaret dhe jo diskriminuese.

Sjellim në vëmendje se barazia para ligjit është një prej te drejtave themelore të garantuar me nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës. Më tutje, në bazë të Nenit 21, paragrafit 4 të Kushtetutës, këtë të drejtë kushtetuese e gëzojnë edhe personat juridik, duke përfshirë edhe kompanitë. Barazia para ligjit, sipas interpretimeve gjyqësore, kërkon që personat (fizik dhe juridik) të kenë trajtim të njëllojtë, kur janë në rrethana të njëjta – siç janë operatorët ekonomik në rastin konkret. Sidoqoftë, në asnjërën nga këto momente nuk u veprua konform legjislacionit në fuqi dhe vendimeve të OSHP-së të lartë cekura, kështu, Operatori Ekonomik OE "NNP "Wenda" Vushtrri, mbeti në garë edhe në procedurën e ri-vlerësimit, përveç se kësaj here tejet më i favorizuar se sa herën e parë.

Prandaj, bazuar në ketë faktet e lartë përmendura, pretendimet tona janë të qëndrueshme dhe, rrjedhimisht OE në fjalë do të duhej te shpallej i pa përgjegjshëm, sepse, është në kundërshtim te plotë me dispozitat nenit 60, par 1, nen par 1.1, dhe ne kundërshtim të plotë me kriteret e përzgjedhjes dhe të vlerësimit të parapara në njoftim për kontratë dhe Dosje të tenderit. Pra, bazuar në dispozitat e nenit 56, par 1, nen par 1.1 dhe 1.2, së pari, bëhet vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kritereve/kërkesave të përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT sipas paragrafit 2 të nenit 51 të këtij ligji dhe, se dytë vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligjit dhe, kriter i dhënies ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët, kurse AK në shkelje të dispozitave të nenit 60, par 1, nen par 1.1, nxjerrë vendim për të shpërblyer me kontratë OE të pa përgjegjshëm.

Kurse, sa i përket Njoftimit te Vendimit te AK për rezultatin e tenderit te datës 12.12.2023, qëndrojmë fuqishme prapa kërkesës për rishqyrtim, për faktin se AK, nuk ka dhënë as një kundër argument, në lidhje me pretendimet tona, të cilat, po të njëjtat qëndrojnë edhe në ketë Ankesë. Provë 5: Kërkesa për rishqyrtim dt.18.12.2023 . Për me tepër, me ketë Vendim AK shkel parimet e përgjithshme dhe themelore të LPP-se, të nenit 1, par, 1; 2 dhe 3, për shkak se, nuk siguron mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, nuk siguron integritetit dhe përgjegjësi dhe nuk ka krijuar një kulture institucionale të profesionalizuar dhe të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, për faktin se nuk ka ofruar trajtim të drejtë dhe të barabartë ne mes të OE, madje në kundërshtim të plotë edhe dispozitat e nen par (d); (h) dhe (o), të par 97.1 të nenit 97 të rregullores 01/2022, për shkak të mos respektimit dhe shkeljeve të parimeve themelore të prokurimit publik të përcaktuar me LPP dhe ne trajtim jo të barabartë të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit, për shkak të mosrespektimit të

vendimeve të OSHP-së, për shkak të mos respektimit të kritereve të përzgjedhjes si dhe për shkak të sjelljeve jo profesionale dhe të gabuara të zyrtarit të prokurimit, për faktin se aplikon kritere/kërkesa të cilat nuk kanë qene të parapara në NJK dhe DT.

Madje, AK nuk ka kërkuar vazhdimin e validitetit të ofertave në kundërshtim me dispozitat e nenit e nenit 30, paragrafit 30.3 dhe 30.5, të RrPP 01/2022, sepse, nuk kërkon me kohë vazhdimin e validitetit të ofertave. Por, përkundër kësaj shkelje ne kemi vazhduar validitetin e ofertave në përputhje me kërkesat e LPP-se. Me ketë veprim, AK ka tejkaluar kompetencat ligjore dhe në shkelje të dispozitave të lartë cekura, sepse, kriter i dhënies ka qenë tenderi me çmimin me te ulët i tenderit të përgjegjshëm, gjë që AK ka shpërblyer OE të pa përgjegjshëm.

Prandaj, pretendimet tona sa i përket dispozitave ligjore të shkelura nga AK qëndrojnë sepse janë ta bazuara dhe te argumentuara dhe të mbështetura në Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren dhe udhëzuesin e prokurimit publik.. Dhe, rrjedhimisht, duke pasur parasysh se, jemi palë me interes juridiko material ne kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-se, sepse jemi të përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmimin me te ulët, kërkojmë nga OSHP-ja, që Ankesën ta trajtoj ne pajtueshmëri më dispozitat ligjore të LPP-se, ta trajtoj ne pajtueshmëri të plotë me kërkesat e parapara ne njoftim për kontratë dhe dosjes së tenderit."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE N.N.P. "HYSNIA" konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni 1 – Qëllimi i aktivitetit të prokurimit, par 1, 2 dhe 3; Neni 7 -, par 1, 2, 6, nen paragrafi (iv),(v) dhe (vi), Neni 28 -, par 2, Neni 51 -, par 1, Neni 59 -, par 4; Neni 60 -, par 1, nen paragrafi 1.1, Neni 64 -, par 1, nen paragrafi (iii), Neni 69-, par 6, nen paragrafi 6.3, të LPP-së II. Dispozitat e Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi RRPP) dhe atë: ? Neni 40, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 40.1; 40.2; 40.6 nen par a),b), c) dhe par 40.13. ? Neni 97, Shkeljet e rënda, par 97.1 nen par (d), (h) dhe (o). III. Mos respektim të vendimit të OSHP-së, PSH nr. 2023/0087 IV. Mos respektim të vendimit të OSHP-së, PSH nr.2023/0494. Duke propozuar Të nxjerrë vendim meritor me të cilin të aprovoj ANKESEN të bazuar të paraqitur nga OE "N.N.P. "HYSNIA", Vushtrri. ? Te anuloj vendimin e AK – Komunës së Vushtrrisë, për refuzim të kërkesës për Ri-shqyrtim, sepse OE N.N.P. "HYSNIA", Vushtrri, ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; ? Te kthej rastin ne Ri-Vlerësim dhe vlerësimi të behet me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë duke shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik të përgjegjshëm që ka dorëzuar çmimin më të ulët. ? Të trajtoj ankesën drejtë, pasi që jemi pale me interes juridiko material dhe kandidat te vetëm potencial për të fituar këtë aktivitetet sipas LPP-së dhe rregullave tjera ligjore në fuqi ? Të urdhëroi AK për zbatim të vendimit të OSHP-se, nr. 2023/0494 ? T'i lëshoj urdhëresë AK për shkak të shkeljeve të renda ligjore të lartë cekura."

***Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim*:** "*Autoriteti Kontraktues - Drejtoria Komunale për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejmë AK.) në bazë të rezultatit nga procesi i ri-ekzaminimit, ri-vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka marrë vendim që ta rekomandoi për dhënie të kontratës: OE: N.N.P. "Wenda" me seli në Dolak - Vushtrri, ndërsa, O.E.: NNP " Hysnia (në*

tekstin e mëtejmë Ankuesin) ta renditë në mesin e OE. të eliminuar, bazuar në procedurën e zbatuar.

Njoftimi mbi Vendimin e AK. si dhe Njoftimi letër për tenderuesin e pasuksesshëm për Ankuesin janë dërguar për publikim në platformën elektronike më dt. 12.12.2023, bazuar në dispozitat e nenit 42 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.

Në Kërkesën për rishqyrtim, Ankuesi konsideron se, duke vendosur si në Vendimin e dt. 12.12.2023, AK. ka shkelur dispozitat e LPP-së, konkretisht: nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, Neni 28 : Specifikimet teknike, Neni 51 : Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes, par l,nenin 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, nenin 64 - Dëshmitë e kërkesave, Neni 60 : Kriteret për Dhënien e Kontratës, Neni 72: Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.

Autoriteti Kontraktues pasi i shqyrtoi një nga një pretendimet e Ankuesit të parashtruara në Kërkesë për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit është e pabazë, për arsye se:

1.Vendimi për ta rekomanduar për dhënie të kontratës OE: N.N.P. Wenda" me seli në Dolak - Vushtrri është marrë në mes tjerash edhe në zbatim të nenit 59 të LPP-së, sepse një tender do të konsiderohet i përgjegjshëm dhe i pranueshëm vetëm nëse përmbushë kërkesat administrative, profesionale dhe minimalisht ato teknike dhe/ose profesionale të saktësuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

2.Lidhur me pretendimin se kërkesa për sqarim të tenderit për dëshmitë e bashkëngjitura në dosjen e tenderit paraqet plotësim material të dosjes së tenderit dhe sipas OE ankues është e ndaluar NUK qëndron sepse nuk kemi te bëjmë ne këtë rast me këto pretendime ankimore andaj një konstatim i tillë nuk qëndron fare, pasi që kërkimi i sqarimeve është i lejuar me nenet 59.2 dhe 72 të LPP-së. Gjithashtu ky veprim i AK lidhur me kërkimin e sqarimeve shtesë gjen mbështetje shtesë dhe të plotë edhe sipas Vendimit 2023/0494 të lëshuar nga OSHP-ja.

3.AK. vlerëson se duke marrë këtë vendim ka pasur parasysh dhe mbrojtjen e parimit VLERA PËR PARANË", duke vlerësuar dhe respektuar fillimisht dispozitat ligjore lidhur me procesin e Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahasimit të tenderëve duke marrë për bazë dhe transparencën, Trajtimin e barabartë të O.E. dhe jo-diskriminim në mes të O.E. duke përfunduar me zbatimin e parimit të " vlera për paranë " i cili në fakt është parim shumë i rëndësishëm për buxhetin e A.K.

dhe të cilin sigurisht se A.K. e ka pasur në konsideratë.

4.Bazuar në të gjitha të cekurat si më lartë në këtë Vendim, A.K. vlerëson se pretendimet e Ankuesit janë të pabazuara, të pasakta. Përfundimisht, A.K. vlerëson se me rastin e marrjes së vendimit si ai i dt. 12.12.2023 për të përzgjedhur për rekomandim me dhënie të kontratës të OE: N.N.P. "Wenda' me seli në Dolak Vushtrri, nuk ka elemente apo prova se janë shkelur dispozitat e cituara si më lartë në këtë Vendim, me theks të veçantë neni 7Barazia në trajtim/ Jo-diskriminimi sepse është rekomanduar O.E. me tender të përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët, ndërsa me asnjë provë nuk është vërtetuar se ndonjë O.E. është trajtuar Jo-barabartë apo diskriminuese, nuk është vërtetuar se nuk ka pasur transparencë apo konkurrencë në mes O.E., neni 51 Njoftimi i kritereve të dhënies së kontratës dhe neni 59 parag.4 - Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, andaj edhe pretendimet e Ankuesit lidhur me këto çështje, sikurse ka konstatuar dhe sqaruar A.K. përmes këtij Vendimi, janë të pabaza, jo të sakta dhe si të tilla janë hedhur poshtë.

Nga sa u tha me lartë, e në pajtim me nenin 62 paragrafi 62.1 pika (d) të Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik për paraqitje të kërkesë për rishqyrtim, A.K. vlerëson se nuk ka asnjë arsye të vendosë ndryshme nga ajo që është thënë si më lartë, andaj dhe është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi."

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 03.01.2024 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1065/2023, ndërsa me datë 12.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/1065 me rekomandimet si në vijim: "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim."

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk Pajohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues. OE pajtohet lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE OE N.N.P. "HYSNIA" eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1065 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i ekspertit shqyrtues për pretendimet ankimore : *"Pas analizimit të ankesës dhe pretendimeve ankimore, si dhe shkresave të lëndës, nuk kemi mund të gjejmë dëshmi se AK ka kërkuar dhe ka pranuar sqarime shtesë ashtu siç është obliguar përmes vendimit të OSHP-se nr.494/23.*

Sipas vendimit të OSHP-së nr.494/23, OSHP ka obliguar AK-në të kërkoj sqarime shtesë për :"obligohet AK qëpërgjatë rivlerësimit të vërtetojë gjendjen faktike në relacion me pretendimet e ngritura në këtëankesë, për më tepër ku OE në ankesën e tij ka pretenduar lidhur me mungesën edokumentacionit lidhur me pajisjet si në vijim:

1. (1) grejder rrafshues min. 12 ton,

2. (1) Cilinder vibrues min. (12-16) ton,

3. (1) Bullduzher për rrafshimin e terenit minimum 8 ton,

4. (1) eskavator (bager) me peshe (20-30)ton".

Marr parasysh që AK nuk ka ndërmarr veprimet e përcaktuara sipas vendimit të OSHP-së nr.494/23, rekomandimi jonë është që ankesa të aprovohet e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim, dhe me rastin e rivlerësimit të respektohet dhe zbatohet vendimi i OSHP-se 494/23.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE N.N.P. "HYSNIA". Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE N.N.P. "HYSNIA"- janë të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës ka gjetur se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Vushtrrisë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:"Mirembajtja e rrugeve e rendit te katërt"., me numër të prokurimit: VU644-22-8608-5-2-1, iniciuar nga (AK) – Komuna e Vushtrrisë.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, pasi qe ankesa e OE ankues përseritet **për herë të tretë** dhe konform Rregullores se Punes se OSHP-së konkretisht neni 16.3 cituar, ne rastet e perserituar me pretendime te njejta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palet jane te njejta, për rastet te cilat janë shqyrtuar më parë, paneli shqyrtues duhet te trajtoj si çështje te gjykuara "res judikata" ne kuptim te nenit 105.2.16 te LPP-së., vendimi i OSHP-se 2023/0494, vendimi i OSHP-se nr. 2023/0087. Po ashtu, eksperti shqyrtues nuk e ka trajtuar lëndën drejtë sepse nuk ka nxjerrë asnjë konstatim dhe ka ardhur në një përfundim të pasaktë se AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar dhe nuk ka respektuar vendimin e OSHP 2023/0494, ndërsa në eprokurim nga

ana e panelit shqyrtues është gjetur që AK ka respektuar vendimin e sipërcituar ngase me datë 08.12.2023 ka kërkuar sqarime në drejtim të OE.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar konform rekomandimeve të vendimeve paraprake të OSHP duke kërkuar sqarime shtesë, dhe duke u bazuar në nenet 59 dhe 60 të LPP ka rekomanduar OE me ofertën më të lirë të përgjegjshëm. Paneli Shqyrtues vlerëson ky aktivitiet i cili është inicuar në vitin 2022 është përcjellur disa herë me ankesa dhe dy herë është kthyer në ri-vlerësim. Andaj, rrjedhimisht paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional konform nenit 59 par. 1 te LPP-së, ku thote: "*Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës*", atëherë në zabim të nenit 1 të LPP-së dhe me qëllim që mos ta prolongohet ky aktivitet i prokurimit edhe më tutje (në pafundësi) dhe duke e pasur parasysh se AK në mendimin e tyre në relacion me raportin e ekspertizës ka deklaruar se është në diskrecion të AK vënia në zbatim edhe e neni 59.4 sa i përket devijimeve të vogla, dhe në mungesë të ndonjë argumenti bindës se OE i rekomanduar mund të jetë i papërgjegjshëm atëherë paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë.Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast

përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit te mbetet ne fuqi vendimi i AK, sepse aplikimi i devijimeve te vogla siç përcakton edhe legjislacioni ne fuqi konkretisht neni 59 par. 4 te LPP-së, ku përgjegjesin ja atribuon autoritetit kontraktues, andaj mbetet ne përgjegjesi dhe diskrecion te Autoritetit Kontraktues aplikimi i kësaj norme, ashtu siç e përcakton edhe dispozita e referuar.

Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Njëherit Paneli shqyrtues vuri në zbatim nenin 1 dhe 6 parimin e ekonomicitetit, si një nga parimet kryesore të nenit 104 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, me ç'rast konstatohet në mënyrë jo kontestuese se oferta e OE të rekomanduar për kontrate konsiston në një çmim me të lirë me poentim në raport me ofertën e ankuesit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E VUSHTRRISË**
- OE - **N.N.P. "HYSNIA"**
- Arkivës së OSHP-së: